

# GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kz. Nr. 312/2012  
Prishtinë  
31 gusht 2012

## NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata Supreme e Kosovës** ka mbajtur seancën e kolegjit në pajtueshmëri me Nenin 26 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe Nenin 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhja e Lëndëve dhe Caktimi i Lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK) më 31 gusht 2012 në ndërtesën e Gjykatës Supreme, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit  
Gjyqtari i EULEX-it Dr. Horst Proetel dhe  
Gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës Nesrin Lushta,  
Marije Ademi dhe  
Salih Toplica si anëtarë të kolegjit  
Dhe me Zyrtarin Ligjor të EULEX-it Holger Engelmann si procesmbajtës,

Avokati mbrojtës N.T.për të pandehurin A.S.,  
Avokatët mbrojtës N.Sh.dhe H.M.për të pandehurin V.D.,  
Avokati mbrojtës A.A.për të pandehurin D.S.,  
Avokati mbrojtës Z.J.për të pandehurin A.V.

Në lëndën penale me numër AP-KZ 312/2012 kundër të pandehurve:

**A.S.**, i lindur më xxxxxxx në fshatin xxxxx, komuna e Gjakovës, Shqiptar i Kosovës, vendbanimi i tij i fundit në fshatin xxxxxxx, emri i të atit P., emri i vajzërisë së nënës M.N., ka të mbaruar shkollën e mesme, me gjendje mesatare ekonomike, i pamartuar, në paraburgim që nga 09 prill 2010;

**V.D.**, me nofkën V., i lindur më xxxxxx në fshatin Firze, komuna e Gjakovës, Shqiptar i Kosovës, vendbanimi i tij i fundit në fshatin Firze, emri i të atit Xh., emri i vajzërisë së nënës K.L., kamerier dhe kuzhinier, ka të mbaruar shkollën e kuzhinierit në Austri, me gjendje ekonomike mesatare, i martuar, baba i tre fëmijëve, i arrestuar më 08 prill 2010 dhe në paraburgim që nga 08 prill 2010;

**D.S.**, i lindur më xxxxxxx në fshatin xxxxx, komuna e Gjakovës, Shqiptar i Kosovës, vendbanimi i tij i fundit në fshatin Zhdrelle, emri i të atit P., emri i vajzërisë së nënës

M.N., punëtor ndërtimi, ka të mbaruar shkollën e mesme, me gjendje mesatare ekonomike, i pamartuar, në paraburgim që nga 09 prill 2010;

A.V., i lindur më xxxxxx në xxxxx, xxxxx, xxxxx vendbanimi i fundit xxxx, xxxxx, emri i të atit A.V., emri i vajzërisë së nënës G. J., ka të mbaruar shkollën e mesme, me gjendje mesatare ekonomike, i divorcuar, me një vajzë, në paraburgim që nga 07 prill 2010;

Në përputhshmëri me aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën me numër P. Nr. 252/2010 të datës 05 gusht 2011 dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të njëjtën ditë, **të pandehurit janë shpallur fajtor për këto veprat penale:**

**A.S., A.V., D.S. dhe V.D. janë shpallur fajtor për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike të rrezikshme në bashkë-kryerje,** në kundërshtim të Nenit 23 dhe Nenit 229 paragrafi 4 (1) në lidhje me paragrafin 2 të KPK-së sepse më 07 prill 2010, në territorin e Kosovës, duke vepruar si anëtarë të grupit dhe në bashkëkryerje, ne mesin e tyre A.S., D.S. dhe V.D. si persona që kanë pasur posedimin material të substancave narkotike, V.D. po ashtu si person që ka kontaktuar A.V.1, personi i cili supozohet të transportonte substancat narkotike jashtë vendit për grupin, ka poseduar dhe transportuar me qëllim të shpërndarjes, shitjes apo të ofrimit për shitje jashtë Kosovës 89 kg dhe 417. 78 gram substance narkotike (marihuan) që përmbante tetrahidrokanabinol (THC)

**A.S. u shpall fajtor edhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** në kundërshtim të Nenit 328 paragrafi 2 të KPK-së, sepse gjatë një periudhe kohore të papërcaktuar por sigurisht deri më 08.04.2010, në fshatin Zhdrellë, ka pasur në posedim armët dhe municionin pa autorizim të vlefshëm të institucionit kompetent: një pushkë automatike AK-47 e kalibrit 7,62 x 39 mm me numër serik 057826-88, tre karikator dhe 47 fishekë të kalibrit 7,62 mm;

**V.D. u shpall fajtor edhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** në kundërshtim të Nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së sepse gjatë një periudhe kohore të papërcaktuar por sigurisht deri më 08.04.2010, në fshatin Firzë, ka pasur në posedim armë dhe municion pa autorizim të vlefshëm të institucionit kompetent: një revole ‘Ekol Special 99’ të kalibrit 9 x 17 mm, me gdhendje ‘P. Beretta’, me numër serik EV8121338, një revole automatike ‘Scorpion’ e kalibrit 7,65 x 17 mm, me numër serik 19336, 56 fishekë të kalibrit 7,62 mm, 14 fishekë të kalibrit 7,65 mm, 6 fishekë të kalibrit 6,35 mm.

**Dhe janë dënuar me sa vijon:**

**I pandehuri A.S.** u dënua për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike të rrezikshme në bashkëkryerje, në kundërshtim të Nenit 23 dhe Nenit 229 paragrafi 4 (1) në lidhje me paragrafin 2 të KPK me gjashtë (6)

vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim dhe një gjobë prej 10.000 Euro dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të Nenit 328 paragrafi 2 të KPK-së me një (1) vit dhe gjashtë (6) muaj burgim. Në pajtueshmëri me Nenin 71 paragrafi 1 dhe 2 të KPK kundër tyre është caktuar dënimi unik prej shtatë (7) vjet burgim dhe një gjobë prej 10.000 Euro.

**I pandehuri V.D.** u dënua për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike të rrezikshme në bashkëkryerje, në kundërshtim të Nenit 23 dhe Nenit 229 paragrafi 4 (1) në lidhje me paragrafin 2 të KPK me gjashtë (6) vjet burgim dhe një gjobë prej 9.500 Euro dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafi 2 të KPK-së me një (1) vit burgim. Në pajtueshmëri me Nenin 71 paragrafi 1 dhe 2 të KPK kundër tij është caktuar dënimi unik prej gjashtë (6) vjet dhe tre (3) muaj burgim dhe një gjobë prej 9.500 Euro.

**I pandehuri D.S.** u dënua për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike të rrezikshme në bashkëkryerje, në kundërshtim të Nenit 23 dhe Nenit 229 paragrafi 4 (1) në lidhje me paragrafin 2 të KPK me pesë (5) vjet burgim dhe një gjobë prej 8.000 Euro.

**I pandehuri A.V.** u dënua për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike të rrezikshme në bashkëkryerje, në kundërshtim të Nenit 23 dhe Nenit 229 paragrafi 4 (1) në lidhje me paragrafin 2 të KPK me katër (4) vjet e gjashtë (6) muaj burgim dhe një gjobë prej 7.000 Euro.

Substancat narkotike, armët dhe municioni janë konfiskuar në pajtueshmëri me Nenet 54, 60, 229 paragrafi 5 dhe 328 paragrafi 5 të KPK, përderisa koha e kaluar në paraburgim që nga 08 prill 2010 deri më 05 gusht 2011 do të llogaritet në dënim në pajtueshmëri me Nenin 391 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 të KPK dhe të pandehurit obligohen të bartin shpenzimet e procedurës penale me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit verbal dhe me shkrim.

Të katër të pandehurit janë liruar nga akuzat në lidhje me veprën penale Krim i Organizuar në pajtueshmëri me Nenin 274 paragrafi 3 të KPK.

**Avokatët mbrojtës** të të akuzuarve në kohë kanë ushtruar ankesa. Ankesa e avokatit mbrojtës të të pandehurit A.S., Av. N.T. është ushtruar më 14 shkurt 2012, ankesa e avokatit mbrojtës për të pandehurin d V.D., Av. N.Sh. është ushtruar më 3 shkurt 2012 dhe ajo e Av. H.M. është ushtruar më 22 maj 2012, përderisa ankesa e avokatit mbrojtës të të pandehurit D.S., Av. A.A. është ushtruar më 13 shkurt 2012 dhe ajo e avokatit mbrojtës të të pandehurit A.V., Av. Z.J. është ushtruar më 19 mars 2012. Të gjitha ankesat në emër të katër të pandehurve vënë në pah se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të Kodit Penal dhe se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve duhej të kundërshtohet. Në të gjitha rastet është propozuar ose të ndryshohet aktgjykimi i kundërshtuar në atë mënyrë që të

pandehurit të lirohen nga të gjitha akuzat, ose të anulohet aktgjykimi dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim si edhe të ndërpritet paraburgimi për të pandehurin A.V..

**Zyra e Prokurorit Special të Kosovës (ZPSRK)** në kohë ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë më 13 shkurt 2012 dhe ka theksuar shkelje të Kodit Penal për shkak të lirimit të katër të pandehurve nga akuzat për krim të Organizuar në pajtueshmëri me Nenin 274 të KPK dhe për dënimin shumë të butë.

**Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK)**, në përgjigjen e datës 26 korrik 2012 dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës më 30 korrik 2012 plotësisht ka mbështetur ankesën e ZPSRK-së dhe ka propozuar që të miratohet ndërsa ankesat e mbrojtjes të refuzohen si të pabazuara.

Bazuar në aktgjykimin me shkrim në lëndën P, Nr. 252/2010 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 05 gusht 2011, ankesat me shkrim të paraqitura nga avokatët mbrojtës përkatës në emër të të pandehurve, të dhënat relevante të lëndës dhe parashtrirat verbale të palëve gjatë seancës dëgjimore më 31 gusht 2012, së bashku me analizën e ligjit në fuqi, pas mbajtjes së këshillimit më 31 gusht 2012, Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë:

## **AKTGJYKIM**

**Ankesat e avokatëve mbrojtës të ushtruara në emër të të pandehurve A.S., V.D., D.S. dhe A.V. si edhe ankesa e paraqitur nga Prokurori Special i Kosovës kundër aktgjykimit P. Nr. 252/2010 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 5 gusht 2011, REFUZOHEN SI TË PABAZUARA.**

**Aktgjykimi i lartë përmendur i gjykatës së shkallës së parë MODIFIKOHET EX-OFFICIO me sa vijon:**

**Vepra penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike të rrezikshme, për të cilën të pandehurit A.S., V.D., D.S. dhe A.V. janë shpallur fajtor, ri-cilësohet sipas Nenit 229 paragrafi 4 pika 1 në lidhje me paragrafin 2 të të njëjtit Nen të KPK-së.**

**Paraburgimi kundër të pandehurve miratohet.**

## **A R S Y E T I M**

**Historia procedurale**

Pas arrestimit të të pandehurve A.S., V.D., D.S. dhe A.V. me datën 8 prill 2010, duke u mbështetur në hetimet policore, të cilët u mbajtën në paraburgim deri më 9 prill 2010, PSRK-ja më datën 26 gusht 2010 ka ngritur aktakuzën pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (PPS nr. 39 / 2010) kundër katër të pandehurve më lart duke i akuzuar të katërtit për veprat penale të krimit të organizuar sipas nenit 274, par. 3 të KPK-së pastaj për blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të substancave të rrezikshme narkotike në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 23 dhe nenin 229, par. 4 (1), lidhur me par. 2 të KPK-së pastaj të pandehurit A.S. dhe V.D. për mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, par. 2 të KPK-së, siç u cek edhe më lart.

Më 20 tetor 2010, gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës ka konfirmuar aktakuzën në tërësi me aktvendimin KA nr. 220 / 10.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke u mbajtur gjithsej 12 seanca më datat 8 dhe 13 prill, më 18 dhe 26 maj, më 21, 22 dhe 23 qershor, më 11 dhe 15 korrik, më 3, 4 dhe 5 gusht 2011, kur është shpallur aktgjykimi i fundit i kundërshtuar.

Gjykata ka dëgjuar të pandehurit A.S., V.D., D.S. dhe A.V. më datat 21, 22 dhe 23 qershor 2011 dhe ka marrë në pyetje dëshmitarët H.T.(13 Prill 2011) dhe K.G.(13 dhe 18 Prill 2011), A.B.dhe B.A.(26 Maj 2011), S.B.dhe F.K.(03 Gusht 2011) dhe S.B. (04 Gusht 2011).

Është lexuar një numër i madh i provave për procesverbal dhe atë si në vijim: raporti KP DKKO i lëndës ndërkuftare Vesa nr. 2010 – DKKO - 005 i datës 9 Prill 2010 i policit kosovar A. A; memorandumi zyrtar nr. 2010 – DKKO – 005 i datës 12 shkurt 2010 i policit kosovar Shemsi Hajziri; raporti nga drejtoria e mjekësisë ligjore nr. 2010 – DKKO - 005, dosja nr. 2010 - 009 VN e datës 9 Prill 2010 i policit kosovar Haki Berisha; raporti mbi bastisjen e kryer në pikën kufitare të Merdares më 7 prill 2010 në automjetin komb ‘Renault’, të cilin e ngiste i pandehuri A.V.; albumi i fotografive nr. 2010 – DKKO - 005, dosja nr. 2010 - 009 VN e datës 7 - 8 prill 2010 dhe i përgatitur nga polici kosovar Haki Berisha lidhur me bastisjen në pikën kufitare të Merdares më datën 7 Prill 2010; memorandumi zyrtar nr. 2010 – DKKO – 005 i datës 7 Prill 2010 dhe i përpiluar nga polici kosovar K.G.lidhur me operacionin e zhvilluar në pikën kufitare Merdares më datën 7 prill 2010, së bashku me tri fotografi; raporti nga drejtoria për mjekësi ligjore nr. 2010 – DKKO - 005, dosja nr. 2010 - 009 VN e datës 09 Prill 2010 e policit kosovar Haki Berisha lidhur me bastisjen e zhvilluar në pikën kufitare të Merdares më datën 7 prill 2010 me foto albumin; procesverbali i bastisjes së banesës në shtëpinë e P. Sylës, nr. 2010 – DKKP - 005 e datës 8 Prill 2010, me procesverbalin e gjërave të konfiskuara dhe shënimet nr. 2010 – DKKO - 005 e datës 8 Prill 2010; procesverbali i bastisjes së shtëpisë së Gjon D.t nr. 2010 – DKKP - 005 e datës 8 Prill 2010, me procesverbalin e gjërave të konfiskuara; raporti i policisë së Kosovës nr. 2010 – DKKO – 005 lidhur me V.D. dhe arrestimin e tij të datës 8 Prill 2010 në orën 10:00; shënimet nr. 2010 – DKKO - 005 e datës 8 Prill 2010 mbi gjërat e konfiskuara; shënimet nr. 2010 – DKKO - 005, e datës 7 Prill 2010, mbi gjërat e konfiskuara të personit A.V.; Memorandumi zyrtar i

policisë së Kosovës, raporti i kontrollit nr. DKKO - NJHF 079 / 2010 i datës 8 Prill 2010; fotografitë e sendeve të gjetura gjatë bastisjes së shtëpisë së P. Sylës; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës, raporti balistik nr. 2010 – DKKO – 005 i datës 8 Prill 2010, raporti i policit kosovar nr. 2010 – DKKO - 005 i datës 8 Prill 2010 dhe fotografitë; raporti i policit kosovar nr. 2010 – DKKO - 005 i datës 8 prill 2010; dokumentet lidhur me arrestimin e të pandehurve A.S. dhe D.S., nr. 2010 – DKKO - 005 i datës 8 Prill 2010; dokumentacioni lidhur me arrestimin e të pandehurit A.V., nr. 2010 – DKKO - 005 dhe mbi gjërat e konfiskuara, i datës 7 Prill 2010; procesverbali i policisë së Kosovës lidhur me personin A.S., D.S. dhe V.D., nr. 2010 – DKKO - 005, i datës 8 Prill 2010; procesverbali i policisë së Kosovës lidhur me A.V., nr. 2010 – DKKO - 005, i datës 9 Prill 2010; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës, nr. 2010 – DKKO - 005 mbi raportin balistik të datës 26 Prill 2010; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës, nr. 2010 – DKKO - 005, lënda Vesa, e datës 26 Prill 2010, raporti mbi ekzaminimin e thirrjeve telefonike; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës, nr. 2010 – DKKO - 005 i datës 26 Prill 2010; raporti i analizës së substancave narkotike; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës nr. 2010 – DKKO - 005, lënda Vesa, e datës 09 Prill 2009 (viti duhet të jetë 2010), raporti 15 – ditësh mbi përgjimin e telekomunikimit për numrin telefonik 044 - 929 991 përgjatë periudhës kohore prej datës 23 mars deri më 8 prill 2010; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës nr. 2010 – DKKO - 005, lënda Vesa, e datës 04 Maj 2010, raporti mbi nxjerrjen e porosive telefonike SMS për numrin telefonik 049 - 126 111; materiali i dorëzuar në PSRK nga avokati mbrojtës Nike Shala për të pandehurin V.D. lidhur me regjistrimin e automjetit të V.D.T, i datës 13 Maj 2010; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës nr. 2010 – DKKO - 005, lënda Vesa, e datës 8 mars 2010 (data mund të jetë gabim sepse duhet të jetë 8 maj 2010); raporti mbi hetimet; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës. nr. 2010 – DKKO - 005, lënda Vesa, e datës 22 Prill 2009 (duhet të jetë 2010), raporti 15 – ditësh mbi përgjimin e telekomunikimit për numrin telefonik 049 - 126 111 përgjatë periudhës kohore prej datës 6 deri më 22 prill 2010 dhe transkriptimet e përgjimeve; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës nr. 2010 – DKKO - 005, lënda Vesa, e datës 12 shkurt 2009 (viti duhet të jetë 2010), raporti 15 – ditësh mbi përgjimin e telekomunikimit për numrin telefonik 044 - 929 991 përgjatë periudhës kohore prej datës 23 janar deri më 6 shkurt 2010; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës nr. 2010 – DKKO - 005, lënda Vesa, e datës 22 shkurt 2009 (duhet të jetë 2010), raporti 15 – ditësh mbi përgjimin e telekomunikimit për numrin telefonik 044 - 929 991 përgjatë periudhës kohore prej datës 7 deri më 21 shkurt 2010; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës nr. 2010 – DKKO - 005, lënda Vesa, e datës 25 Prill 2009 (duhet të jetë 2010), raporti mbi të dhënat e nxjerra nga numri telefonik 049 -126 111 për periudhën kohore prej 6 deri më 22 Prill 2010 me 82 faqe numra telefonikë dhe të dhëna të tjera të bashkangjitura (në gjuhën angleze); disku DVD me versionin në programin “word” për të dhënat e nxjerra nga numri telefonik 049 - 126 111, nr. 914 - 2 i datës 11 maj 2010; raporti nr. 2010 – DKKO - 005, lab nr. 2010 - 0871, nr. GJPP nr. 80 / 2010, i datës 19 Maj 2010, raporti mbi ekzaminimin balistik të revoles Beretta ne numër serik EV 8121338; arma automatike Scorpion nr. 19336, pushka automatike AK - 47 nr. 057826, arma me numrin serik 1824 dhe arma e gjuetisë me numrin serik 14061; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës nr. 2010 – DKKO - 005, lënda Vesa, e datës 28 July 2010, raporti plotësues i vëzhgimit; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës nr. 2010 – DKKO - 005, lënda Vesa, e datës 6 Gusht 2010, raporti plotësues;

Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës nr. 2010 – DKKO - 005, lënda Vesa, e datës 12 Gusht 2010, raporti lidhur me ekzaminimin e pajisjeve elektronike të katër të pandehurve si të SIM kartelave dhe të laptopëve të tyre; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës nr. 2010 – DKKO - 005, nr. 2010 – TIFK - 024, i datës 21 qershor 2010, raporti i provave lidhur me telefonat celularë Nokia; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës nr. 2010 – DKKO - 005, nr. 2010 – TIFK - 024, i datës 21 qershor dhe 14 korrik 2010, raporti final i provave lidhur me gjërat e konfiskuara nga i pandehuri A.V.; raporti nr. 2010 – DKKO - 005, lab nr. 2010 - 0871, lënda nr. GJPP Nr. 80/2010, e datës 19 korrik 2010, raporti i mjekësisë ligjore mbi drogat; Memorandumi zyrtar i policisë së Kosovës nr. 2010 – DKKO - 005, urdhri për kthimin e gjësendeve (pushkës së gjuetisë me një tytë me numër serik 14061, pronë e A.D., një pushke me numrin serik 1824, pronë e G.D., të cilat u janë kthyer babait të tyre Xh. D.; Memorandumi zyrtar nr. 2010 – DKKO - 005, lënda Vesa, e datës 09 Prill 2009 (duhet të jetë 2010) raporti për numrin telefonik 044 - 929 991 të A.S.gjatë periudhës kohore prej datës 23 mars deri më 8 prill 2010 dhe transkriptimet e bisedave telefonike.

Duke u mbështetur në gjetjet e veta, më 5 gusht 2011, Gjykata e Qarkut shpalli aktgjykimin e kontestuar dhe shpalli të pandehurit në fjalë fajtorë për veprat penale të përmendura më sipër. Rrjedhimisht, gjykata u shqiptoi të pandehurve dënimet të cilat po ashtu janë përmendur më lart.

**Avokatët mbrojtës** të të akuzuarve me kohë kanë ushtruar ankesat e tyre ashtu siç është theksuar më parë duke pretenduar se aktgjykimi në fjalë përmban shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të kodit penal dhe se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve do të kundërshtojë. Në të gjitha këto raste është propozuar ose të ndryshohet aktgjykimi i kontestuar duke i liruar të pandehurit në fjalë nga të gjitha akuzat ose të prishet aktgjykimi si dhe të kthehet lënda për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë si dhe të ndërpritet paraburgimi ndaj të pandehurit A.V..

**Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK)** me kohë ka ushtruar ankesë ndaj aktgjykimit të shkallës së parë siç u shtjellua më lart duke pretenduar shkeljen e kodit penal për shkak të lirimimit të katër të pandehurve nga akuzat për krim të organizuar sipas nenit 274 të KPK-së si dhe për dënimin tepër të butë.

**Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK)** me përgjigjen e tyre të datës 26 korrik 2012 dhe të regjistruar në shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës më datën 30 korrik 2012 kanë mbështetur në tërësi ankesën e PSRK-së dhe kanë propozuar aprovimin e saj ndërsa refuzimin e ankesave të mbrojtjes si të pabaza, ashtu siç është shtjelluar më lart.

Më 31 Gusht 2010, Gjykata Supreme ka mbajtur seancën në përputhje me nenin 410 të KPPK-së.

Avokatët mbrojtës kanë konfirmuar parashtrirat dhe kërkesat e tyre.

## GJETJET E GJYKATËS

### **A. Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale**

Mbrojtja ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që dispozitivi do të ishte në kundërshtim me veten si dhe me arsyetimin. Për më tepër, arsyetimi i aktgjykimit si i tillë do të ishte në kundërshtim me faktet materiale dhe me provat personale të administruara gjatë procedurës gjyqësore. Kështu, neni 403, par. 1, pikat 12 dhe 8, par. 2 dhe 3 të KPPK-së do të shkeleshin.

Sa i përket të pandehurit V.D., gjykata kishte mbështetur gabimisht fajësinë e tij në lëvizjet e të pandehurit, të cilat në fakt nuk janë të mjaftueshme fare për ta fajësuar. Për më tepër, parimi *actus rea* i të pandehurit nuk ishte vërtetuar siç kërkohet me ligj. Gjëja e fundit por jo më e parëndësishmja është se aktgjykimi në fjalë nuk kishte marrë parasysh disa fakte në favor të të pandehurit, siç është p.sh. fakti që ekzistojnë pasiguri lidhur me tabelat e regjistrimit të veturës Mercedes e cila është shfrytëzuar ditën kritike.

Sa i përket të pandehurit D.S., është kundërshtuar se gjykata nuk kishte vlerësuar në mënyrë objektive dëshmitë e dëshmitarëve në veçanti të dëshmitarëve H. T., K.G.A.B., B.A., A. A, S. N, F.K.dhe S.B. të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjukata nuk i kishte kushtuar vëmendje të duhur versionit të ngjarjeve të prezantuara nga i pandehuri. Në fund, faktet vendimtare nuk ishin përshkruar në mënyrë të mjaftueshme.

Ndërsa lidhur me të pandehurin A.V., mbrojtja ka kundërshtuar aktgjykimin lidhur me shpalljen fajtor të tij për blerjen, posedimin, shpërndarjen dhe shitjen e paautorizuar të substancave të rrezikshme narkotike në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 23 dhe nenin 229, par. 4 (1), lidhur me par. 2 të KPK-së, i cili aktgjykim ka qenë i mbështetur jo vetëm në dëshmi të paqëndrueshme të dhëna nga dëshmitarët e marrë në pyetje nga policët, por edhe në përgjime të thirrjeve telefonike të cilat nuk ishin aprovuar nga gjyqtari kompetent apo të cilat nuk kishin vula të gjykatës siç përcaktohet me ligj. Përkundër faktit se aktgjykimit të kontestuar i mungonin arsyet lidhur me faktet vendimtare; gjykata nuk kishte vlerësuar në mënyrë të tërësishme versionet e ngjarjeve të prezantuara nga ana e mbrojtjes.

Lidhur me të pandehurin A.S. është thënë se aktgjykimit të kundërshtuar gjoja i mungonte jo vetëm arsyetimi i duhur por edhe se dispozitivi i tij ishte në kundërshtim me arsyetimin e provuar. Për më tepër, aktgjykimi nuk ishte i mbështetur në faktet e vërtetuara në shqyrtimin gjyqësor, pasi që përfshirja e të pandehurit në blerjen, posedimin, shpërndarjen dhe shitjen e paautorizuar të substancave të rrezikshme narkotike është refuzuar nga i pandehuri dhe nga personat e tjerë. Për më tepër, aktgjykimi është i mbështetur në prova të papranueshme, pasi që porositë SMS dhe përgjimet e bisedave telefonike ishin fituar në mënyrë të kundërligjshme dhe në veçanti fakti se nuk i është ofruar asnjë sqarim mbrojtjes se për çfarë arsye urdhri përkatës i gjykatës GJPP Nr. 36 / 10, i datës 23 janar 2010 dhe i datës 6 shkurt 2010 nuk ka qenë në



shkresat e lëndës dhe në të nuk ka pasur qasje mbrojtja para se ai urdhër të dorëzohej nga ana e prokurorit në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

## I. MOSPËRPUTHJA E PRETENDUAR E AKTGJYKIMIT TË KUNDËRSHTUAR NË LIDHJE ME DISPOZITIVIN DHE ARSYETIMIN

Gjykata Supreme konstaton se nuk mund të vërtetohet asnjë mospërputhje qoftë në dispozitivin apo në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar në fjalë.

### 1. Përputhja e brendshme e tërë dispozitivit:

Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë përmban të gjitha elementet e kërkuara me nenin 396 paragrafët 3 dhe 4 në lidhje me nenin 233 paragrafin 1 dhe nenin 391 të KPPK-së. Reflekton jo vetëm të dhënat personale të të pandehurve, por gjithashtu në mënyrë të qartë sqaron veprat penale për të cilat të pandehurit janë shpallur fajtorë së bashku me faktet dhe rrethanat të cilat tregojnë natyrën kriminale të veprave të kryera të cilat janë relevante për zbatimin e dispozitave të referuara të ligjit penal, e tëra siç kërkohet me nenin 391 paragrafin 1 pikën 1 të KPPK-së. Kjo e fundit vlen për fajësinë e të gjithë katër të pandehurve për Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 23 dhe nenit 229 paragrafit 4 (1) në lidhje me paragrafin 2 të KPK-së si dhe fajësimin individual të pandehurve A.S. dhe V.D. për Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së, siç është cekur në dispozitivin e aktgjykimit të kundërshtuar (*f.2 dhe 3 e versionit në gjuhën angleze*).

### 2. Vendimi mbi lirimin e pjesëshëm të të pandehurve:

Në lidhje me lirimin e të gjithë katër të pandehurve nga akuzat për Krim të organizuar sipas nenit 274 paragrafit 3 të KPK-së, Gjykata Supreme vëren se në të vërtetë tre rreshtat e vendimit siç janë dhënë në dispozitiv nuk i përmbushin plotësisht kushtet e nenit 396 paragrafit 3 të KPPK-së, sipas të cilit në rast të lirimit *dispozitivi duhet të përmbajë përshkrimin e veprës penale për të cilën ai apo ajo akuzohet*.

Sidoqoftë, aktgjykimi i kundërshtuar në pjesën relevante të dispozitivit të tij i bën referencë të qartë aktakuzës së konfirmuar në tërësi, e cila i është dorëzuar të gjithë të pandehurve dhe avokatëve mbrojtës përkatës dhe për më tepër shtjellon mbi çështjen në detaje në pjesën e arsyetimit (*f. 19 e versionit në gjuhë-n angleze*). Pasi që aktgjykimi duhet të lexohet si një dokument i tërë, Gjykata Supreme në lëndën në fjalë është kënaqur se – sa i përket minimumit – aktgjykimi i kundërshtuar është në përputhje me ligjin gjithashtu edhe në lidhje me vendimin mbi dënimin.

### 3. Mospërputhjet në mes të dispozitivit dhe arsyetimit:

Asnjë mospërputhje nuk është vërtetuar në mes të dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit të kundërshtuar, e as nuk janë mbështetur me asnjërën nga ankesat.

#### 4. Mospërputhjet e arsytimit:

Sa i përket mospërputhjeve të pretenduara të arsytimit, Gjykata Supreme gjen se arsytimi i aktgjykimit të shkallës së parë – edhe pse është përpiluar në mënyrë të pazakonshme dhe vështirë që të përcillet – në mënyrë të hollësishme vlerëson dhe analizon provat e prezantuara dhe plotësisht reflekton të gjitha provat e prezantuara para trupit gjykues të shqyrtimit gjyqësor.

##### a. Vlerësimi jo i plotë i pretenduar i provave të prezantuara para trupit gjykues të shqyrtimit gjyqësor:

Edhe pse vlerësimi i provave në rend të parë është pjesë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të mundshme, çështja tanimë mund të ketë pasur ndikim në arsytimin e duhur dhe konsistent siç është kundërshtuar në lëndën në fjalë.

Sidoqoftë, Gjykata Supreme gjen se Gjykata e Qarkut tërësisht ka vlerësuar të gjitha deklaratat e dëshmitarëve si dhe provat tjera në dispozicion në shkresat e lëndës dhe se aktgjykimi – megjithatë në format të pazakonshëm – përmban edhe vlerësimin individual edhe atë të përgjithshëm të provave të prezantuara.

Në veçanti, në lidhje me Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 23 dhe nenit 229 paragrafit 4 (1) në lidhje me paragrafin 2 të KPK-së (si në lidhje me akuzat për Krim të organizuar sipas nenit 274 paragrafit 3 të KPK-së), Gjykata e Qarkut jo vetëm që ka dëgjuar të gjithë dëshmitarët relevant në veçanti H. T., K.G.A.B., B.A., S. N, F.K.dhe S.B., por gjykata gjithashtu ka interpretuar deklaratat e tyre në lidhje me provat tjera vërtetuese si SMS porositë e dërguara në mes të pandehurve si dhe rezultatet e përgjimit të telefonatave.

Gjykata e Qarkut nuk është e obliguar që më parë t'i besoj një grupi të dëshmitarëve në dëm të tjerëve, por është e lirë që të vlerësojë provat e prezantuara dhe të arrij në konstatimin e saj në lidhje me kredibilitetin e dëshmitarëve. Gjykata e shkallës së parë ka konsideruar në mënyrë të mjaftueshme këtë çështje dhe ka arritur në përfundim të kuptueshëm dhe të qëndrueshëm.

Për dallim nga ajo që pretendohen në ankesat e mbrojtjes, Gjykata e Qarkut ka vlerësuar në hollësi versionet e ngjarjeve relevante siç janë përshkruar nga të pandehurit (*f.19 e versionit në gjuhën angleze*), por ka arritur në përfundim se këto versione alternative nuk janë të besueshme dhe prandaj nuk janë të vlefshme që në mënyrë efektive të kundërshtojnë provat e prezantuara nga Prokurori. Edhe pse rezultati përfundimtar siç është paraqitur në f.19 të aktgjykimit në versionin në gjuhën angleze është mjaft i izoluar, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim të duhur në lidhje me atë se pse kanë

konstatuar se versioneve të pandehurve ju mungon besueshmëria, gjithashtu siç mund të lexohet deri në faqen 19 të aktgjykimit në gjuhën angleze.

b. Pamjaftueshmëria e pretenduar në lidhje me përshkrimin e fakteve vendimtare:

Lidhur me pretendimin – në mënyrë mjaft të pambështetur – për pamjaftueshmërinë e përshkrimit të fakteve vendimtare në arsyetim, referencë i bëhet asaj që është thënë më parë nën pikën I.1. të këtij aktgjykimi.

## II. PAPANUESHMËRIA E PRETENDUAR E PËRGJIMIT TË SMS-VE DHE TELEFONATAVE

Avokatët mbrojtës në veçanti të pandehurve A.V. dhe A.S. kanë theksuar se rezultatet e përgjimit të SMS-ve dhe telefonatave janë prova të papranueshme, pasi që masat nuk janë aprovuar nga gjyqtari përgjegjës përkatësisht i mungojnë vultat e nevojshme të gjykatës siç kërkohet me ligj.

Gjykata Supreme konstaton se pretendimet janë pa merita. Duke i kontrolluar të gjithë urdhrat për fillimin e masave të fshehta dhe vazhdimin e tyre përkatës, Gjykata Supreme ka gjetur se urdhrat për vëzhgimin e fshehtë të fotografimit apo video vëzhgimit në vendet publike janë lëshuar nga Prokurori publik në pajtim me nenin 258 paragrafin 1 pikën 1 të KPPK-së, kurse urdhrat për përgjimin e telefonatave janë lëshuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake siç kërkohet me nenin 258 paragrafin 2 pikën 4 të KPPK-së.

Nuk jep sqarime, pse gjyqtari i procedurës paraprake nuk do të duhej të ishte gjyqtar kompetent për miratimin e masave në fjalë, siç kundërshtohet nga mbrojtja. Në veçanti, mungesa e vulate të gjykatës në disa versione në gjuhën shqipe të dokumenteve të tilla siç është theksuar nga mbrojtja nuk e dëmton vlefshmërinë e urdhrave pasi që ato përmbajnë nënshkrimin e gjyqtarit kompetent.

Sa i përket çështjes së ngritur nga avokati mbrojtës i të pandehurit A.S., Av. N.Th, se kinse urdhri i Gjykatës së Qarkut GJPP Nr. 36/10 i datës 23 janar 2010 mbi përgjimin e telefonatave në mes të 23 janarit dhe 6 shkurtit 2010 nuk ka qenë në qasje të mbrojtjes deri në seancën e 8 prillit 2012, Gjykata Supreme i bën referim të plotë asaj që Gjykata e Qarkut tanimë ka vendosur në lidhje me këtë. Nuk mund të vërtetohet asnjë shkelje e dispozitave të procedurës penale në këtë mënyrë.

Pasi që Kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut i ka rekomanduar mbrojtjes në seancën e 8 prillit 2012 që të kërkojë një kopje të dokumentit dhe pasi që mbrojtja e ka pranuar një kopje të tillë pas kërkesës së tij gjatë seancës së 13 prillit 2012 (*procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 13 prill 2012, f.3*), Gjykata e Qarkut ka vendosur në seancë më 13 prill 2012 dhe ka bërë të qartë se data e gabuar 2009 siç përmbajnë urdhrat për përgjim është një gabim shtypi.

## **B. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike**

Mbrojtja e të gjithë katër të pandehurve ka kundërshtuar se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vërtetuar faktet në mënyrë të duhur. Gjykata kishte vërtetuar fajësinë e tyre në lidhje me veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm edhe pse i pandehuri ka mohuar të ketë qenë i përfshirë ndonjëherë në aktivitete kriminale të këtij lloji. Në veçanti, avokati mbrojtës i të pandehurit A.V. ka theksuar përsëri se sipas deklaratave të pandehurit ky i fundit nuk ka pasur njohuri se substancat narkotike ishin depozituar në bagazhin e veturës së tij kur ai ka kaluar kufijtë e Kosovës më 7 prill 2010, por se ai është kthyer në Kosovë atë ditë vetëm se kishte dashur të shes çokollata këtu.

Referencë i bëhet asaj që është thënë nën pikën A të këtij aktgjykimi. Gjykata Supreme gjen se në lëndën në fjalë nuk mund të konstatohet vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike. Gjykata e Qarkut ka vlerësuar në hollësi të gjitha provat në dispozicion siç parashihet me ligj dhe ka arritur në përfundimet e saj.

Në veçanti, sa i përket të pandehurit A.V. dhe versionit të tij të ngjarjeve më 7 prill 2010, është kuptuar se versioni i tij i shitjes së çokollatave në Kosovë nuk ka qenë asnjëherë në fokus të hetimeve as gjatë fazës së hetimeve e as gjatë shqyrtimit gjyqësor. Megjithatë, në vend të kësaj gjykata e shkallës së parë ka shtjelluar në detaje lidhur me thirrjet telefonike në mes të pandehurve A.S. dhe V.D. dhe ka vlerësuar gjatë çështjen e mungesës së karburanteve dhe rrjedhjes së vajit lidhur me veturën e vozitur nga i pandehuri A.V. në ditën përkatëse. Në bazë të të gjitha provave të prezantuara dhe vlerësuara, Gjykata ka përfunduar se ka qenë A.V., të pandehurit A.S. dhe V.D. duke komunikuar se ku kishin për qëllim që të takoheshin (*aktgjykimi i kundërshtuar, f.14-17 e versionit në gjuhën angleze*).

Gjykata Supreme e Kosovës vazhdimisht ka theksuar se nuk është as në kompetencë të kolegjit për ankesa e as mundshme në fakt që të zëvendësohet gjetjet e gjykatës së shkallës së parë me ato të vetat, posaçërisht jo pa i marrë të gjitha provat përsëri. Për herë të parë në lëndën *Runjeva, Axgami dhe Dema (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZ 477/05 i datës 25 janar 2008, faqe 20)*, Gjykata Supreme e Kosovës në këtë kontekst ka theksuar se “*procedura ankimore në KPPK-ë mbështetet në parimin se është detyrë e trupit gjykues që të dëgjoj, vlerësoj dhe peshoj provat në gjykim [ ... ]. Prandaj, gjykata e apelit duhet t’i jap hapësirë të mjaftueshme gjykatës së faktit që të konstatoj gjetjet e veta faktike. Ajo nuk duhet të çrregulloj gjetjet e gjykatës së faktit për t’i zëvendësuar me ato të vetat, përveç nëse provat në të cilat është mbështetur gjykata e faktit nuk do të mund të pranoheshin nga asnjë gjykatë e arsyeshme e faktit ku vlerësimi i tyre ka qenë “tërësisht i gabuar”*.”

Kjo e fundi nuk vlen në lëndën në fjalë, për këtë arsye nuk ka vend për Gjykatën Supreme që të ndërhyjë dhe të zëvendësoj rezultatin e vlerësimit të Gjykatës së Qarkut ose të urdhëroj gjykatën e shkallës së parë se si të vlerësoj provat në dispozicion.

### C. Shkelja substanciale e ligjit penal

Të gjithë avokatët mbrojtës konstatojnë se dobësia e pretenduar e lartpërmendur e aktgjykimit të shkallës së parë në lidhje me procedurën penale dhe në veçanti pretendimi i vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike domosdoshmërisht ka shpër në shkeljen e ligjit penal duke shpallur të pandehurit fajtorë dhe duke i dënuar ashtu siç është shpallur nga Gjykata e Qarkut.

Gjithashtu PSRK-ja – e mbështetur nga ZPShK-ja – ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë për shkelje substanciale të ligjit penal pasi që katër të pandehurit janë liruar nga akuzat në lidhje me veprën penale Krim i organizuar sipas nenit 274 paragrafit 3 të KPK-së, edhe pse kushtet e ligjit janë përmbushur dhe provuar nga ana e Prokurorit.

Gjykata Supreme gjen se pohimet e mbrojtjes janë pa merita, duke pasur parasysh se të gjitha ankesat konstatojnë vetëm shkeljen substanciale të ligjit penal si rezultat i shkeljes se pretenduar të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Referencë i bëhet asaj që është thënë në kontekstin përkatës të lartpërmendur. Pasi që asnjëra nga shkeljet e pretenduara nuk është vërtetuar më parë dhe nuk është mbështetur asnjë shkelje e mëtutjeshme e ligjit penal nga mbrojtja, nuk ka nevojë që të shtjellohet më thellë lidhur me këtë çështje.

Sa i përket pretendimeve të PSRK-së dhe ZPShK-së, Gjykata Supreme pajtohet me vlerësimin ligjor siç është dhënë nga Gjykata e Qarkut (*f.19 e aktgjykimit të kundërshtuar në versionin në gjuhën angleze*). Gjykata në veçanti ka gjetur se “*provat e prezantuara nuk janë të mjaftueshme në mënyrë që të bazohet aktgjykimi fajësues në lidhje me ekzistimin e veprës penale Krim i Organizuar. Në fakt ajo që prokuroria ka vërtetuar është se katër të pandehurit [...] kanë vepruar së bashku për të importuar nga Shqipëria dhe të transportojnë jashtë Kosovës substancat narkotike. [...] Prokuroria nuk ka vërtetuar ekzistimin e një grupi të strukturuar për një periudhë kohore dhe veprimin në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së krimeve.*”

Definicionet lidhur me ‘krimin e organizuar’ dhe ‘grupin e organizuar kriminal’ siç i referohen në nenin 274 paragrafin 3 të KPK-së është përcaktuar me nenin 274 paragrafin 7 pikat 1 dhe 2 të KPK-së, sipas të cilit “*shprehja ‘krim i organizuar’ do të thotë krim i rëndë i kryer nga një grup i strukturuar për të përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi dobi pasurore a financiare*” kurse shprehja “*grup i organizuar kriminal do të thotë grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtpërdrejtë ose tërthortë të dobisë pasurore apo financiare*”.

Përderisa, aktakuza e datës 26 gusht 2010, lidhur me akuzat kundër katër të pandehurve për Krimin e organizuar të pretenduar sipas nenit 274 paragrafit 3 të KPK-së i referohet bisedave telefonike në mes të pandehurit A.S. dhe një personi të quajtur B.H.më 23 janar 2010 dhe aktiviteteve të transportimit të drogës të pandehurit A.V.më 06/07 prill 2010, të cilat gjithashtu janë objekt i aktgjykimit të kundërshtuar. Gjykata e Qarkut ka vlerësuar në hollësi lëvizjet e të gjithë të pandehurve më 07 prill 2010 (f.8-9 e aktgjykimit të

kundërshtuar në gjuhën angleze) dhe gjatë ka marrë parasysh rezultatet e përgjimeve të telefonatave dhe SMS-ve – mjaft të koduara – të telefonave mobil të të pandehurve siç janë ofruar në shkresat e lëndës. Megjithatë, gjykata nuk ka qenë në gjendje të dëshmojë asgjë tjetër përveç asaj më 06/07 prill 2010, p.sh. në një rast të vetëm një sasi prej 89 kg dhe 417,78 gramëve të marihuanës janë trafikuar nga të pandehurit. Në veçanti, nuk janë sjellë dëshmi të mjaftueshme në lidhje me ekzistimin e një grupi të organizuar me zinxhir komandues të qartë dhe ndarjen e detyrave, që ka ekzistuar për një periudhë kohore të matshme me qëllim të kryerjes së krimeve të rënda, siç kërkohet me ligj.

Prandaj, Gjykata Supreme gjen se vendimi *in dubio pro reo* i Gjykatës së Qarkut në lidhje me akuzat për Krim të organizuar është i saktë dhe në përputhje me gjetjet e gjykatës dhe me ligjin.

#### **D. Cilësimi i veprës penale të kryer**

Gjykata Supreme e Kosovës *ex-officio* është dashur ta ri-cilësoj veprën penale të kryer nga A.S., V.D., D.S. dhe A.V. sipas pikës dy të aktakuzës. Gjykata e shkallës së parë ka shpallur katër të pandehurit fajtorë për kryerjen e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 23 dhe nenit 229 paragrafit 4 nën-paragrafit 1 në lidhje me paragrafin 2 të KPK-së.

Sidoqoftë, elementi i cilësimit “...si anëtarë i një grupi” i nenit 229 paragrafit 4 nën-paragrafit 1 të KPK-së tanimë përmban elementin e bashkëkryerjes dhe *lex specialis* për këtë vepër të veçantë penale ka përparësi ndaj dispozitës së përgjithshme të nenit 23 të KPK-së. Nuk është e mundur që të aplikohen të dy dispozitat në mënyrë kumulative pasi që kjo do të përbënte fajësim të dyfishtë për të njëjtën rrethane cilësuese. Si rrjedhojë, gjykata është dashur ta largojë elementin e bashkëkryerjes sipas nenit 23 të KPK-së nga pjesa fajësuese e dispozitivit.

#### **E. Vendimi mbi dënimin**

Përderisa të gjithë avokatët mbrojtës janë të mendimit se për shkak të gabimit të pretenduar të gjykatës së shkallës së parë dhe dobësisë së aktgjykimit të kundërshtuar klientët e tyre duhet të lirohen, PSRK-ja e mbështetur nga ZPShK-ja janë të bindura se dënimi është tepër i butë, jo vetëm duke pasur parasysh se të pandehurit është dashur të shpallen fajtorë për veprën penale Krim i organizuar sipas nenit 274 paragrafit 3 të KPK-së por gjithashtu duke pasur parasysh se gjoja gjykata nuk ka marrë parasysh rrethanat rënduese.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se vendimi mbi dënimin është i drejtë. Gjykata e shkallës së parë në pajtim me kornizën e dënimeve të mundshme të përcaktuar me ligjet përkatëse ka shqiptuar dënime të ndara për secilin të pandehur, A.S., V.D., D.S. dhe A.V. për veprat e tyre penale përkatëse në pajtim me kornizën e përcaktuar në dispozitat e ligjit penal të referuar dhe sipas vlerësimit të peshës së kontributit të tyre dhe fajit individual ë lidhje me krimet e kryera. Në rastin e A.S.dhe V.D.T në bazë të dënimeve të ndara të shqiptuara kundër tyre, dënimet unike prej gjithsej shtatë (7) viteve burgim në rastin e A.S.dhe gjashtë (6) viteve dhe tre (3) muajve në rastin e V.D.T janë shqiptuar sipas nenit 71, paragrafëve 1 dhe 2, pikës (2) të KPPK-së, kurse në pajtim me ligjin gjobat e shqiptuara prej 10,000 € në rastin e A.S.dhe 9,500 € në rastin e V.D.T janë mbështetur.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të saktë dhe të plotë ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në ashpërsinë e dënimit dhe i ka vlerësuar ato në mënyrë të drejtë. Në vazhdim të asaj që është thënë në lidhje me shkëljet e mundshme nga ana e gjykatës së shkallës së parë siç pretendohet nga mbrojtja, nuk mund të gjendet asnjë arsye për lirimin e të pandehurve ose së paku për uljen e dënimeve. Pasi që Gjykata Supreme pajtohet me vlerësimin e Gjykatës së Qarkut për lirimin e të pandehurve nga akuzat në lidhje me Krimin e organizuar sipas nenit 274 të KPK-së, në anën tjetër nuk është parë asnjë mundësi për rritjen e dënimeve siç është kërkuar nga ana e Prokurorit.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka gjetur se ri-cilësimi i veprave të kryera kërkon përcaktim të ri të dënimeve. Largimi i elementit juridik të ‘bashkëkryerjes’ ka pasur të bëjë vetëm me korrigjimin e një gabimi juridik. Elementi i përgjithshëm i përmendur tanimë përmbahet në cilësimin e nenit 229 paragrafin 4 nën-paragrafin 1 të KPPK-së (“...si anëtar i një grupi”). Dispozita e përmendur *lex specialis* ka përparësi ndaj dispozitës së përgjithshme të nenit 23 të KPK-së, të cilat nuk mund të aplikohen në mënyrë kumulative së bashku me dispozitën e parë të përmendur. Sidoqoftë, shkalla e përgjegjesisë penale mbetet e njëjtë për të gjithë të pandehurit.

Gjithashtu duke pasur parasysh shkallën e rrezikut shoqëror të arritur me kryerjen e veprave penale në fjalë si dhe shkallën e përgjegjesisë së të pandehurve, dënimet janë në proporcion me peshën e veprave të kryera dhe rrethanat individuale përkatëse dhe shkallën e përgjegjesisë penale të vërtetuar për secilin prej tyre.

#### **F. Vazhdimi i paraburgimit derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë**

Avokati mbrojtës i A.V. në ankesën e tij me shkrim dhe të gjithë avokatët tjerë mbrojtës gjatë fjalës së tyre përfundimtare kanë propozuar që të pandehurit të lirohen nga paraburgimi.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se nuk ekziston asnjë arsye për t’i liruar të pandehurit nga paraburgimi, pasi që dyshimi i bazuar kundër të gjithë të katër të pandehurve është vërtetuar në mënyrë të qartë me faktin se ata janë shpallur fajtorë nga gjykata e shkallës së parë dhe se aktgjykimi i kundërshtuar është vërtetuar nga Gjykata

Supreme dhe duke pasur parasysh situata nuk ka ndryshuar në asnjërin nga rastet, pra të gjitha arsyet për paraburgim ende ekzistojnë.

Në bazë të arsyeve të lartpërmendura, Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv.

**Anëtarët e kolegjit:**

---

**Valdete Daka**  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

---

**Dr. Horst Proetel**  
Gjyqtar i EULEX-it

---

**Nesrin Lushta**  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

---

**Emine Kaqiku**  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

**Kryetar i kolegjit:**

Procesmbajtës

---

**Gerrit-Marc Sprenger**  
Gjyqtar i EULEX-it

---

**Holger Engelmann**  
Zyrtar ligjor i EULEX-it

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**Ap.-Kž. Nr. 312/2012**  
**Prishtinë**  
**31 gusht 2012**

**Këshillë juridike**

Sipas nenit 430 të KPPK-së, kundër këtij aktgjykimi nuk mund të paraqitet ankesë.